



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

THIRRJE PËR APLIKIM PËR TRAJNERË PROFESIONISTË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon të kontraktojë deri në 6 trajnerë profesionistë, të cilët do të angazhohen me kërkesë të KQZ për trajnimin të kandidatëve për trajnerë për administratën zgjedhore, mësimdhënie në video regjistrim përmes platformave e-learning si dhe kontribute në hartim të moduleve në funksion të proceseve zgjedhore.

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË APLIKANTËT:

Trajnerët profesionistë duhet të kenë formim universitar së paku të ciklit të dytë dhe të kenë një përvojë në mësimdhënie jo më pak se 10 vjet në institucionet e arsimit të lartë apo të angazhuar si trajner nga organizatat e njohura vendase apo ndërkombëtare, mundësisht me një eksperiencë si trajner I trajnerëve në proceset zgjedhore të mëparshme. Preferohen trajnerë profesionistë të certifikuar nga KQZ si të tillë. Vlerësimi i trajnerëve profesionistë kryhet nga DAZ përmes përmbushjes së kriterëve si dhe intervistës për këtë qëllim.

Trajneri profesionist duhet të jetë i paangazhuar në struktura drejtuese qendrore e vendore të partive politike dhe të mos ketë patur aktivitete të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor

Të mos jetë në detyrë në strukturat e organeve të Policisë së Shtetit, Policisë gjyqësore, Gardës së Republikës, inspektoriat qendror apo lokal, ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura, punonjës i Shërbimit Informativ, organeve të pushtetit gjyqësor;

Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

Të mos jetë i dënuar administrativisht për shkelje të dispozitave, të cilat lidhen me zgjedhjet, apo të mos ketë masë disiplinore në fuqi në shërbimin civil.

Aplikimi:

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin brenda datës 22.11.2024

Aplikimet të bëhen online në linkun bashkëlidhur:

<https://forms.office.com/e/hcZqXpQDR3>

DOKUMENTACIONI:

1. Kërkesë e nënshkruar e aplikantit;
2. Kopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti/pasaportë);

3. Jetëshkrim (CV) Europass e përditësuar, ku të pasqyrohet adresa e postës elektronike dhe numri telefonik i kontaktit;
4. Diplomë e arsimit të lartë (e noterizuar);
5. Kopje e librezës së punës (e noterizuar);
6. Çertifikatë personale të lëshuar nga portali e-albania;
7. Çertifikatë kualifikimi, trajnimi ose dokument tjetër, që vërteton eksperiencën si pedagog apo trajner;
8. Vetëdeklarimin e nënshkruar sipas modelit bashkëlidhur.
9. Aplikantët e punësuar duhet të dorëzojë edhe lejen nga titullari i institucionit për lejimin e tij në kryerjen e kësaj veprimtarie për periudhën e kërkuar.

Diploma e arsimit të lartë mund të jetë e panoterizuar për aplikantët të cilët kanë qenë të angazhuar si trajnerë, në zgjedhjet e fundit të organeve të qeverisjes vendore,

KQZ brenda shtatë ditëve nga afati i fundit të dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët, pas vlerësimit të aplikimeve, njofton aplikantët e kualifikuar për intervistimin e tyre në KQZ.

Fazat e vlerësimit të aplikimeve

- a. Vlerësim i kriterëve përmes dokumentacionit. Kualifikohen në këtë fazë të gjithë kandidatët që përmbushin kriteret dhe kanë dokumentacionin e plotë.
- b. Të gjitha dosjet/aplikimet e kualifikuara në fazën e parë, pikëzohen dhe rankohen nga kandidati me më shumë pikë dhe vijuar me rend zbritës.
- c. Njoftohen elektronikisht për intervistën nga KQZ.

Detajet e angazhimit të tyre, pagesës sipas ngarkesës dhe detyrimeve të tjera përcaktohen në kontratën që KQZ do të lidhe me trajnerët profesionistë.